

V E N D I M
Nr.371, datë 26.7.1993

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.529, DATË
11.12.1992 "PËR KRITERET DHE KOMPETENCAT E ORGANEVE SHETETËRORE E
PRIVATE NË FUSHËN E STANDARTIZIMIT DHE TË CILËSISË"**

Me propozimin e Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 11.12.1992, neni 15 ndryshohet si vijon:

"Drejtoria e Standardizimit dhe Cilësisë është organ shtetëror buxhetor që krijon të ardhura nga veprimtaria e saj. Përdorimi i të ardhurave bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.478, datë 7.11.1992 "Për krijimin, evidencimin dhe administrimin e të ardhurave që realizojnë institucionet buxhetore nga shërbimet që u ofrojnë të tretëve".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi